



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 1 dhjetor 2015  
Nr. ref.:RK863/15

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI77/15**

Parashtrues

**Naser Foniqi**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK/nr. 18/2015, të 11 marsit 2015**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe  
Bekim Sejdiu, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Naser Foniqi me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar është Vendimi [KGJK/nr. 18/2015] i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK), i 11 marsit 2015.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin, siç pretendohet, është bërë shkelja e nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], nenit 107 [Imuniteti] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe shkeljet thelbësore të Ligjit për Gjykatat dhe Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm të Gjykatave.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 16 qershor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 15 tetor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe KGJK-në për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 12 nëntor 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Parashtruesi i kërkesës është gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Më 11 prill 2014, Zyra e Prokurorit Disiplinor (në tekstin e mëtejme: ZPD), inicioi procedurën disiplinore kundër parashtruesit të kërkesës para KGJK-së për shkak të sjelljes joprofesionale, keqpërdorimit të funksioneve gjyqësore dhe shkeljes së Kodit të zbatueshëm të Etikës.
10. Më 1 gusht 2014, KGJK-së, pas procedurës së zbatuar [me Vendimin KD. nr. 10/2014], vendosi që të qortoje parashtruesin e kërkesës për shkak të sjelljes joprofesionale, keqpërdorimit të funksioneve gjyqësore dhe shkeljes së Kodit të zbatueshëm të Etikës.
11. Më 8 shtator 2014, i pakënaqur me vendimin e lartpërmendur, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Komisionin e shkallës së dytë të KGJK-së. Përveç

parashtruesit të kërkesës, edhe ZPD-ja paraqiti ankesë ndaj vendimit të përmendur.

12. Më 11 mars 2015, Komisioni i shkallës së dytë i KGJK-së [me Vendimin KGJK/nr. 18/2015] refuzoi ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe ZPD-së si të pabazuara dhe vërtetoi vendimin e Komisionit Disiplinor të KGJK-së.

### **Pretendimet e parashtruesit**

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se KGJK-ja me vendimin e kontestuar i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe nenin 107 [Imuniteti] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
14. Parashtruesi kërkon nga Gjykata:

*„Me këtë kërkesë dua që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të anuloj vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK. nr. 18/15, të datës 11.03.2015 [...]”.*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

15. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:  
*„Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
17. Gjithashtu, Gjykata i referohet edhe nenit 47. 2 të Ligjit, i cili përcakton:  
*„Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
18. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së Punës, i cili parasheh:  
*„Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar.”*
19. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës deklaroi se KGJK-ja me vendimin e kundërshtuar i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
20. Në këtë rast mund të vërehet se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, pasi që

parashtruesi i kërkesës e ka pasur të drejtën e ankesës ndaj vendimit të kontestuar të KGJK-së para Departamentit për Kontestet Administrative të Gjykatës Themelore.

21. Gjykata më tej rikujton se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës të shterojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.
22. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih Aktvendimin për papranueshmëri: *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).
23. Prandaj, Gjykata është e mendimit që kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.
24. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 12 nëntor 2015, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi